

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit (Programi: Master i mësimdhënies në matematikë)
Titulli i lëndës:	Mësimdhënia dhe të nxënit e matematikës II
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (Sem II)
Numri i orëve në javë:	3+2 (5 orë)
Vlera në kredi – ECTS:	7 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Eda Vula, Ass. Blerina Tafolli
Detajet kontaktuese:	eda.vula@uni-pr.edu , blerina.tafolli@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Ky kurs është vazhdim i kursit Mësimdhënia dhe të nxënit e matematikës I. Studentët do të zhvillojnë në mënyrë të veçantë shkathtësi për zhvillimin mësimdhënies për të menduarit matematik, të kuptuarit konceptual dhe zbatimin e njohurive dhe shkathtësive për zgjidhjen e problemeve matematikore dhe atyre nga jeta e përditshme. Ata do të aftësohen që të harmonizojnë njohuritë specifike të lëndës së matematikës me praktikat bashkëkohore pedagogjike, të zhvillojnë planifikime për zhvillimin e të kuptuarit të numrave, koncepteve nga gjeometria, algjebra, probabiliteti, statistika, trigonometria dhe analiza matematike. Zgjidhja e problemeve kontekstuale e bazuar në parimet e edukimit realist matematikor; analiza e niveleve të van Heiles për të menduarit gjeometrik; modelimet matematikore dhe roli i matematikës në dhe për qasjen e integruar STEM, do të jenë bazë për hulumtim dhe reflektim gjatë zhvillimit të lëndës.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi parësor i kursit është zhvillimi i njohurive, dhe shkathtësive të nevojshme të studentëve për zbatimin e kurrikulës dhe njohurive pedagogjike të përmbajtjes gjatë punës me nxënës në orët e matematikës. Kjo lëndë synon të zhvillojë qëndrime dhe vlera pozitive në mësimdhënien dhe nxënien e matematikës duke inkurajuar kureshtjen, këmbënguljen, vlerësimin e zbatimeve të matematikës në jetën reale.</p>

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të kursit studentët do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shqyrtojnë njohuritë pedagogjike për përmbajtjet matematikore sipas kurrikulës, burimet e nevojshme për mësimdhënien e matematikës dhe shfrytëzimi i mjeteve dhe teknologjisë; • planifikojnë mësimdhënien duke u bazuar në parimet e edukimit realist matematikor, modelimet matematikore, nivelet e van Heile-s dhe qasjen e integruar STEM; • integrojnë njohuritë matematikore me ato nga fushat tjera kurrikulare dhe modelojnë zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme; • dizajnojnë aktivitete efektive dhe reflektojnë për të menduarit algjebrik, gjeometrik dhe koncepteve tjera nga trigonometria, statistika e probabiliteti; • analizojnë të arriturat në fushën e mësimdhënies nga hulumtimet në fushën e edukimit matematikor dhe shfrytëzimin e IA për personalizimin e të nxënit; • vlerësojnë rolin e matematikës për zhvillimin e qëndrimeve dhe vlera pozitive në punë dhe jetë.
---	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	12	12
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	6	1	6
Detyra të shtëpisë	3	10	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	14	42
Përgatitja përfundimtare për provim	2	3	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, prezantime, provim final)	2	2	4
Totali 25x7 = 175 orë			175

Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Prezantime, aktivitete ndërvepruese, puna në grupe, punë individuale, punë në çifte, punë seminarike/projekte.</i>												
Metodat e vlerësimit:													
<p><i>Vlerësimi i studentëve:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Angazhimi në orët e ushtrimeve (zbatimi i kurrikulës në klasë) 20%</i> 2. <i>Angazhimi në diskutime dhe reflektime gjatë ligjëratave (10%)</i> 3. <i>Planifikimet individuale të mësimëve (10%)</i> 4. <i>Projekti hulumtues (30%)</i> <p><i>Studentët do të punojnë në grupe për të prezantuar planifikimet dhe realizimet e projekteve që në fokus kanë mësimdhënien e bazuar në hulumtime dhe edukimin për STEM)</i></p> <p><i>4 Provimi përfundimtar 30 %</i></p> <p><i>Provimi përfundimtar përmban pyetje dhe detyra nga temat e diskutuara gjatë semestrit dhe leximi i materialeve të sugjeruara gjatë semestrit.</i></p>													
<p>Nota përfundimtare:</p> <table> <thead> <tr> <th>Pikët(%)</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>90-100</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>80- 89</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>70 -79</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>60-69</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>50-59</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table>		Pikët(%)	Nota	90-100	10	80- 89	9	70 -79	8	60-69	7	50-59	6
Pikët(%)	Nota												
90-100	10												
80- 89	9												
70 -79	8												
60-69	7												
50-59	6												
Literatura													
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Brahier, J.D., (2024). Teaching Secondary and Middle School Mathematics 7th Edition. Routledge 2. Groth, E. Randall (2013). Teaching Mathematics in Grades 6-12. Developing Research-Based Instructional Practices. Sage Publicatio, Inc.. 3. <i>Van de Walle, J. Karp, K., Bay-Williams, J., & Wray, J. (2018). Elementary and middle school mathematics: Teaching developmentally (10th ed.). Pearson Education. Inc.</i> 4. <i>Vula. E. (2021). Mësimdhënia dhe të nxënit e matematikës. Modelimet me gjurmime matematiore, Universiteti i Prishtinës</i> 												
Literatura shtesë:	<i>KKK. KB2 dhe KB3 MASHT; Librat e mësuesit Shënim: Si literature shtesë do të përdoren edhe punimet shkencore dhe profesionale për mësimdhënien e matematikës dhe burime tjera të nevojshme.</i>												

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Paraqitja e kursit. Qëllimet dhe detyrat. Kurrikula dhe planet e programet për fushën/lëndën e matematikës
Java e dytë:	Njohuritë për mësimdhënien e matematikës. Burimet dhe mjetet.
Java e tretë:	Strategjitë kognitive dhe metakognitive. Zbatime në klasa
Java e katërt:	Edukimi realist matematik. Parimet dhe fazat.
Java e pestë:	Problemet kontekstuale, edukimi realist matematik dhe të nxënësve jashtë klasës.
Java e gjashtë:	Planifikimi për mësimdhënie (Përdorimi i IA për planifikim). Diskutim për përparësitë dhe sfidat
Java e shtatë:	Të menduarit algjebrik. Modelet, funksionet dhe përgjithësimet. Aktivitetet që mbështesin të menduarit kritik e kreativ.
Java e tetë:	Zhvillimi i të menduarit gjeometrik dhe nivelet e Van Heile-s
Java e nëntë:	Zhvillimi i të menduarit gjeometrik dhe nivelet e Van Heile-s. Njohuritë pedagogjike për konceptet gjeometrike.
Java e dhjetë:	Modelimet matematikore – strategjitë
Java e njëmbëdhjetë:	Zhvillimi i të menduarit të nxënësve për statistikën dhe probabilitetin. Shembuj
Java e dymbëdhjetë:	Edukimi për STEM – roli i matematikës si disiplinë e integruar me fushat tjera kurrikulare
Java e trembëdhjetë:	Roli i matematikës në zhvillimin e qëndrimeve dhe vlerave pozitive për punë dhe jetë
Java e katërmëdhjetë:	Prezantimi i projekteve
Java e pesëmbëdhjetë:	Provimi përfundimtar
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Çdo student duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viojë me rregull ligjëratat; - Lexojë literaturën e kërkuar dhe artikujt e sugjeruar, të marrë pjesë në diskutimet në klasë, të përgatitet për të gjitha aktivitetet tjera; - Përgatitë dhe dorëzojë të gjitha detyrat në kohën e duhur. Çdo vonesë dhe mos pjesëmarrje në orë do të ndëshkohet me pikë të humbura; - Përdorë stilin APA në të gjitha detyrat e shkruara (shih shembuj në Doracakun për shkrimin e tezës së Masterit); - Nuk lejohet kopjimi dhe gjatë orëve mësimore nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë (përveç kur kërkohet nga mësimdhënësi); - Në provimin përfundimtar kanë të drejtë të paraqiten vetëm studentët që kanë marrë pjesë në ligjëratat dhe ushtrimet dhe që kanë kryer detyrat gjatë kursit; - Studentët kanë të drejtë të hyjnë në provimin përfundimtar më së shumti tri herë (Neni 118 i Statutit të UP-së). 	